



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P.nr.640/14

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtares, Florije Zatriqi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Bute Noci, në çështjen juridiko-penale kundër të pandehurve: J.B. dhe L.B. që të dy nga Peja rr.“Heronjt e Dukagjinit”, për shkak se në bashkëveprim kanë kryer vepër penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, R.B nga Peja rr. “Fatmir Uka”, nr.1 për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1770/2014 të dt. 16.09.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, me dt.23.02.2017, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Lumturije Vuçetaj, të pandehurve: J.B, L.B dhe R.B, me datë 23.02.2017, murr, publikisht shpalli dhe me datë 10.03.2017 e përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. I pandehuri J.B**, i lindur me, në P, nga babai Xh dhe nëna N e gjinisë Gj, me banim në rr. “H.D” nr..., ka, i gjendjes së ... ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal, lëshuar nga MPB-Prishtinë, më parë i padënuar nga gjykata, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 2. I pandehuri L.B**, i lindur me, në P, nga babai Xh dhe nëna N e gjinisë Gj, me banim në rr. “H e D” nr..., ka të kryer shkollën, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal 1003680564, lëshuar nga MPB-Prishtinë, më parë i padënuar nga gjykata, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

- 3. I pandehuri R.B,** i lindur me 26.01.1962, në Pejë, nga babai N dhe nëna S e gjinisë M, me banim në rr. "F U" nr., ka të kryer, i gjendjes ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal, lëshuar nga MPB-Prishtinë, më parë i padënuar nga gjykata, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Për shkak se:

Të pandehurit: J.B dhe L.B

1. Me datë 26.08.2014, rreth orës 08:20 minuta, në Pejë, pikërisht në lagjen afër "Hamam Xhamisë", me dashje dhe në bashkëveprim i shkaktojnë lëndime të rënda trupore të dëmtuarit R.B, në atë mënyrë që pas një zënke një ditë më parë lidhur me myshterinjtë, i dëmtuari fillimisht ju del përpara me një kaçavidë (shafciger), dhe e godet në dorë të pandehurin J.B dhe menjëherë ky i fundit e godet me grushta të dëmtuarin ku më pas i bashkëngjitet edhe i pandehuri Liridon dhe që të dy e godasin në pjesë të ndryshme të trupit, derisa i dëmtuari është mbetur i shtrirë për tokë,
 - me çka, në bashkëveprim kanë kryer veprë penale, lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 të KPRK-së.

I pandehuri R.B

2. Me datë 26.08.2014, rreth orës 08:20 minuta, në Pejë, pikërisht në lagjen afër "Hamam Xhamisë", me dashje i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit J.B nga Peja, në atë mënyrë që pas një zënke një ditë më parë lidhur me myshterinjtë, i pandehuri i del përpara të dëmtuarit me një kaçavidë (shafciger) dhe e godet në dorë këtë të fundit, ku pastaj edhe i dëmtuari Jeton fillon që të përleshet me të, e këtij të fundit i shkakton lëndime trupore,

- me çka ka kryer veprën penale, *lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par.1 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata konform dispozitave të nenit 7, 8 par.1, 9, 10 par.1, 17 par, 1, 21 par. 1 dhe 2, 41, 42, par.1 nën par. 1.1, 46, 50, 51, 52 par.1 dhe 4, 73, 74, dhe 188 të KPRK-së, dhe neni 189 par.1 të KPRK-së, nenit 245, 246, 248 par.1 dhe 4, 359, 360, 361, 365, 366, 450 dhe 463 të KPRK-së, të pandehurve :

J.B dhe L.B, për veprën penale nga pika 1 e dispozitivit të aktgjykimit ju shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Duke ju përcaktuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej **nga tetë (8) muaj**, të cilin dënim të pandehurit nuk do ta mbajnë nëse, nëse në afat prej **një (1) viti**, nuk do të kryejnë veprë

të re penale, duke ju llogaritur edhe kohën e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 26.08.2014 e gjerë datën 15.09.2015.

Të pandehurit J.B dhe L.B, obligohen që në mënyrë solidare gjykatës t'ia paguajnë shpenzimet e procedurës penale, në shumë prej **njëzetë (20) euro** dhe paushallin gjyqësor në shumë prej nga **njëzetë (20) euro**, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari R.B, ka hjek dorë nga kërkesa për kompensimin e dëmit.

Të pandehurit R.B, për veprën penale nga pika 2 e dispozitivit të aktgjykimit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Duke ja përcaktuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej **tre (3) muajve**, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbaj, në nëse në afat prej **një (1) viti**, nuk do të kryenë veprë të re penale.

I pandehuri R.B, obligohet që gjykatës t'ia paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej **njëzetë (20) euro** dhe paushallin gjyqësor shumën prej **njëzetë (20) euro**, në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari J.B, ka hjekë dorë nga kërkesa për kompensimin e dëmit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzën PP/II.nr.1770/2014 të dt. 16.09.2014, kundër të pandehurve: J.B dhe L.B që të dy nga Peja rr.“Heronjtë e Dukagjinit”, për shkak se në *bashkëveprim kanë kryer veprë penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së*, dhe ndaj të pandehurit R.B nga Peja rr. “Fatmir Uka”, nr.1 për shkak të veprës penale, *lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së*. Të pandehurit J.B dhe L.B, kanë qëndruar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 26.08.2014 e gjerë datën 15.09.2015.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me dt. 21.04.2016, në prezencë të prokurorit të shtetit dhe të pandehurve, ku të pandehurit u njoftuan me të drejtat e tyre, u njoftua me aktakuzën dhe provat kundër tyre. Pas kësaj prokurori lexoj aktakuzën kundër të pandehurve.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit, të pandehurit J.B dhe L.B u deklaruan fajtor për veprën penale me të cilën ngarkohen, ndërsa i pandehuri R.B u deklarua i pafajshëm për veprën penale nga pika 2 e dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me datën 11.07.2016, mbajti seancën e dytë gjyqësore, ndërsa i pandehuri R.B, nuk ka ushtruar kundërshtimet sipas udhëzimeve të gjykatës, por i njëjti gjatë shqyrtimit

gjyqësor të mbajtur me dt. 23.02.2017, u deklaroi i fajshëm për veprën penale për të cilën akuzohet.

Pas deklarimit të të pandehurve, se e pranojnë fajësinë dhe mendimit të prokurorit i cili nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë, gjykata konstatoi se të pandehurit pranojnë fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, të pandehurit janë të vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par.1 të KPPRK-së, janë përmbushur. Andaj, gjykata aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve.

Duke pas parasysh se të pandehurit kanë të drejtë që në çdo fazë të procedurës të deklarohen për pranimin e fajësisë, gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 326 par.4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të të pandehurve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 248 par.4 të KPPRK-së, ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare të saj ka deklaruar se, të pandehurit bënë pranimin e fajësisë për veprat penale të cilat u vihen në barrë, dhe të njëjtit para kësaj gjykate treguan gatishmëri për shtrirjen e dorës njëri tjetrit, me çka konsideron se me këtë akt njerëzor dhe human të njëjtit arritën marrëveshje në mënyrë vetë, andaj me këtë u vërtetua se të njëjtit janë penalisht përgjegjës për veprat penale të cilat u vihen në barrë, andaj i propozon gjykatës që të njëjtit ti shpall fajtor, ti dënoj sipas ligjit dhe ti obligoj në paguarjen e shpenzimeve procedurale, ndërsa me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin i propozon gjykatës që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, arritja e marrëveshjes dhe pajtimi në mes tyre, premtimi se nuk do të përsërisin veprime të tilla në të ardhmen, ndërsa si rrethanë rënduese të merren pesha e veprës penale dhe mënyra e kryerjes.

I pandehuri J.B në fjalën përfundimtare deklaroi se: që nga fillimi e ka pranuar fajësinë për këtë veprë penale dhe këto veprime shpreson se në të ardhmen nuk do të përsëriten, ngase me të pandehurin R. jetojnë në një lagje dhe janë miq familjarë dhe e faleminderon të njëjtin që gjatë kësaj seance u arrit marrëveshja e pajtimit në mes tyre, andaj, e lut gjykatën që këto të gjitha t' i ketë parasysh dhe të ja shqiptoj një dënim sa më të ultë.

I pandehuri L.B në fjalën përfundimtare deklaroi se: që nga fillimi e ka pranuar fajësinë për këtë veprë penale dhe këto veprime shpreson se në të ardhmen nuk do të përsëriten, ngase me të pandehurin R. jetojnë në një lagje dhe janë miq familjarë dhe e faleminderon të njëjtin që gjatë kësaj seance u arrit marrëveshja e pajtimit në mes tyre, andaj, e lut gjykatën që këto të gjitha t' i ketë parasysh dhe të ja shqiptoj një dënim sa më të ultë.

I pandehuri R.B, në fjalën përfundimtare të tij ka deklaruar se: pasi që e ka pranuar fajësinë për këtë veprë penale dhe këto veprime shpreson se në të ardhmen nuk do të përsëriten, nga se me këtu të pandehurit Jeton dhe L.B, jetojnë në një lagje dhe me të njëjtit janë miqë familjar dhe i falemindron të njëjtit dhe gjykatën që gjatë kësaj seance u arrit marrëveshja e pajtimit në mes tyre, andaj e lut gjykatën që këto të gjitha t' i ketë parasysh dhe të ja shqipton një dënim sa më të ultë, nuk kërkon kompensimin e dëmit nga të pandehurit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurve: J.B dhe L.B, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të kryer në bashkëveprim, lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe të pandehurit R.B qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë, gjykata ka gjetur se tek të pandehurit ka ekzistuar dashja që veprat penale ti kryejnë në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që të pandehurit kanë qenë të vetëdijshëm për veprat e kryera dhe e kanë dëshiruar kryerjen e tyre.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të të pandehurve, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me vendimin mbi dënim, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurit gjykata gjeti se të pandehurit ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor, e për më tepër kanë pranuar fajësinë dhe kanë shpreh keqardhje për veprat që i kanë kryer. Të pandehurit gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë shtri dorën e pajtimit me njërin tjetrin, janë miqë familjar, kanë deklaruar se nuk kërkojnë kompensimin e dëmit, i premtojnë gjykatës se në të ardhmen nuk do ti përsëritin veprimet e veta. Gjithashtu të pandehurit asnjëherë më parë nuk kanë ra ndesh me ligjin si dhe ndaj tyre nuk udhëhiqet ndonjë procedurë penale. Andaj të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të të pandehurve. Si rrethana rënduese për të pandehurit gjykata pati parasysh peshën e veprës penale dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, gjykata në kuptim të nenit 73 të KPRK -së, të pandehurit i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

Duke u bazuar në nenin 450 par.2 nënpar.2.6 të KPRK-së, gjykata ka obliguar të pandehurit që ti paguajnë shpenzimet procedurale në shumë prej nga njëzetë (20) euro, dhe

paushallin gjyqësor shumë prej nga njëzetë (20) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar gjatë kësaj procedure penale.

Meqenëse nga ana e palëve nuk pat kërkesë për kompensimin e dëmit, andaj gjykata nuk vendosi në këtë drejtim.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 370 të KPPRK.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË –DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.640/14

Sekretarja juridike

Gj y q t a r j a

Bute Noci

Floriqe Zatriqi

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit. Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.